



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 21, datë 28.03.2023

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE	
Autoriteti shitës	
Hetim Administrativ, iniciuar nga	<ul style="list-style-type: none">• APP <input checked="" type="checkbox"/>• Reklamim nga të tretë <input type="checkbox"/>
Numri i procedurave të verifikuara	1 (një)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë ankand publik "E hapur"
Konstatimet kryesore	<p>1. Autoriteti Shitës nuk ka vepruar në përputhje me kreun V të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, lidhur me mospërcaktimin e grafikut të lëvrimit të mallit dhe afatit përfundimtar të ekzekutimit të kontratës, si dhe mosargumentimin e numrit të punonjësve të kërkuar, në procedurën e ankandit objekt hetimi administrativ.</p> <p>2. Autoriteti Shitës nuk ka vepruar në përputhje me kreun V të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, lidhur me moszhvillimin e procedurave përkatëse për përcaktimin e vlerës së hapit, si dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues, në procedurën e ankandit objekt hetimi administrativ.</p>
Masat e marra	Në bazë të nenit 7, pika 2, gërmat "b" dhe "c", të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar, APP vendosi t'i propozojë titullarit të Autoritetit Shitës marrjen e masës disiplinore, ndaj 3 personave, anëtarë të njësisë së ankandit, të evidentuar përgjegjës, sipas konstatimeve në këtë vendim.